



Pranuar / Dorezuar Punljena/Prodato Received/Delivery	10-08	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKESHILLI	4647/2022		1/4	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.597/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.597/2022 të datës 05.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Ferizajt, kundër Vendimit Nr.26/2022 të datës 14.06.2022 të Zyrës së Personelit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.597/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.26/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë se Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

### A r s y e t i m

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datën 12.05.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për grupin e pozitave Specialist Ligjor, gjegjësisht për pozitën Zyrtar Ligjor - 2 në Zyrën Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Ferizaj.

Menaxherja e Personelit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, me datën 09.06.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.23/2022, sipas të cilit ankuesit i është refuzuar aplikimi për pozitën

Zyrtar ligjor 2 në Zyrën Rajonale për Ndhimë Juridike Falas në Ferizaj, me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret e parapara me konkurs lidhur me përvojën e punës.

Kundër Vendimit Nr.23/2022 të datës 09.06.2022, ankuesi me datën 13.06.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas. Kjo e fundit me Vendimin Nr.26/2022 të datës 14.06.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar me arsyetimin se i njëjti nuk i ka dy (2) vite përvojë pune.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.26/2022 të datës 14.06.2022, me datën 05.07.2022 ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 3924/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:3924/2022 të datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin e datës 08.03.2018 për kryerjen e praktikës; Certifikatën e datës 30.12.2016 për kryerjen e praktikës gjyqësore; Vërtetimin për punësim të datës 08.03.2018; Vendimin Nr.26/2022 të datës 14.06.2022 lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit; Ankesën e ankuesit të datës 13.06.2022 e parashtruar tek NJBNJ; Vendimin Nr.23/2022 të datës 09.06.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit e ankuesit; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën prej 01.07.2017-12.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.07.2022 nga Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 15.07.2022 nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas së bashku me dëshmitë për ankesën e ankuesit; Vendimin Nr.11/2022 të datës 21.04.2022; Konkursin e datës 12.05.2022 për pozitën Zyrtar ligjor 2 në Zyrën Rajonale për Ndhimë Juridike Falas në Ferizaj; Listën e aplikantëve konkurrues; Njoftimin e datës 09.06.2022 lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve aplikues; Aplikacionin për punësim të ankuesit të datës 25.05.2022 me numër të referencës RN00008856 së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës; Njoftimin e datës 14.06.2022 lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës gjegjësisht Konkursit me numër RN00008856, të datës 21.04.2022 ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale për Ndhimë Juridike Falas në Ferizaj, kanë qenë:

- *Diplomë të studimeve universitare, Fakulteti Juridik me të paktën 180 kredi /ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Sipas shkresave të administruara të lëndës rezulton se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës si dëshmi lidhur me përvojën e punës ka dërguar: Certifikatën e datës 30.12.2016 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj me të cilën dëshmohet se ka

përfunduar praktiken gjyqësore prej një (1) viti nga data 05.01.2016 deri me 31.12.2016; Vërtetimin e datës 08.03.2018 të lëshuar nga Tetra Tech me të cilën dëshkohet se ankuesi nga data 01.06.2017 deri më 30.11.2017, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, ka qenë praktikant në Gjykatën Themelore në Ferizaj, përmes Projektit për të Drejtat Pronësore në Kosovë i financuar nga USAID; Vërtetimin e datës 08.03.2018 të lëshuar nga Tetra Tech me të cilën dëshkohet se ankuesi ka punuar si Zyrtar ligjor në Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore nga data 12.12.2017 deri me datë 08.03.2018.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se e plotëson kriterin e përvojës së punës, ka analizuar shkresat e lartcekura dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me rastin e aplikimit dhe rrjedhimisht të pranuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, nuk e plotëson kriterin e përvojës së punës prej dy (2) vitesh, sepse siç është cekur edhe me lartë i njëjti sipas Certifikatës së datës 30.12.2016 ka dëshmuar përvojën e punës praktike prej një (1) viti, gjegjësisht nga data 05.01.2016 deri me 31.12.2016 në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa me Vërtetimin e datës 08.03.2018 ka dëshmuar përvojën e punës praktike në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, gjegjësisht nga data 01.06.2017 deri më 30.11.2017 në Gjykatën Themelore në Ferizaj - përmes Projektit për të Drejtat Pronësore në Kosovë i financuar nga USAID; Po ashtu ankuesi si dëshmi lidhur me përvojën e punës ka dorëzuar edhe Vërtetimin e datës 08.03.2018 të lëshuar nga Tetra Tech me të cilën dëshkohet se ankuesi ka punuar si Zyrtar Ligjor në Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore nga data 12.12.2017, mirëpo meqenëse vërtetimi është lëshuar me datë 08.03.2018, Kolegji i Këshillit përvojën e punës si Zyrtar Ligjor e konsideron valide vetëm deri me datë 08.03.2018 sepse ankuesi nuk ka dorëzuar dëshmi tjetër ku vërtetohet se ankuesi ende është duke vazhduar të punojë në atë vend të punës, dhe në këtë kuptim është konstatuar se ankuesi sipas shkresave të dorëzuara ka gjithsej një (1) vit e gjashtë (6) muaj pune praktike, dhe tre (3) muaj përvojë pune, ku të gjitha së bashku nuk e arrijnë përvojën e punës prej dy (2) vitesh ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi në aplikacionin e tij me numër të referencës RN00008856 të datës 25.05.2022 ka theksuar se ka punuar si Zyrtar Ligjor në Programin e USAID-it për të Drejtat Pronësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën prej 12.12.2017 deri me 31.08.2018, mirëpo për përvojën e punës pas datës 08.03.2018 nuk ka sjellë dëshmi. Andaj pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me përvojën e punës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti nuk ka përmbushur kriterin e përvojës së punës e kërkuar me konkurs prej *“Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”* dhe po ashtu përvoja e tij e punës si praktikantë në kohëzgjatje prej me shume se një (1) vit, bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 03/L-122 të Punës, përkatësisht nenin 16 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të larte mund të zgjasë me se shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj”*.

Andaj, bazuar si me sipër konstatohet se Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Prot.26/2022 të datës 14.09.2022 ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar ligjin material duke vepruar kështu


në përputhje me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 47, nenin 48 paragrafi 1 dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda: A.nr.597/2022

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtoreshës Ekzekutive në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas;
- Arkivoit të KPMSHCK- së.

